ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**VET-FKEE2020-24-1699-5-1-1**
Nr i brendshëm	**VET-FKEE2020-24-004-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Angazhimi i Kompanive për kryerje të punëve ndërtimore për implementimin e masave të Efiçencës së Energjisë në ndërtesat shumë banesore sociale.**

NIKA Pro-ing Sh.P.K & Anion Mep Constracting
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Rexhep Bislimi, Ferizaj
(Adresa)

Ferizaj
(Vendi)

71 000
(Kodi postar)

044 249 864
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Shpend Musa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nika.proing@gmail.com
(Adresa elektronike)

18.06.2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)

NIKA PRO-ING SH.P.K NPI FERIZAJ

(Nënshkrimi dhe vula)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 25.03.2024 Hapja e ofertave: 05.04.2024 Njoftimi mbi vendimin e AK-: 30.05.2024 Kërkesa për ri-shqyrtim- : 04.06.2024 Vendimi i kerkese per ri-shyqrtim: 06.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim

Me daten 30.05.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, AK na keni eliminuar kem menudare se eshte vendim i pa drejt dhe per kete ju kemi dretju edhe KRPP me kerkes per interpretim,

Pretendimi 1. Ju si AK na keni kërkuar leter për sqarim ku keni kërkuar dokumentet e ATK dhe Gjykaten me datë 21.05.2024 dhe ne ju kemi drejtu kërkesën edhe antarit të koncersiumit dhe i njejtie na ka dërguar dokemtentet e kerkuara mirpo njeri dokumente i gjykates nuk leshohet njejt sikurse ne vendin tone pasi kompania është nga Katari dhe i njejti ka aplikuar ne gjykaten supreme te Qatar-it për një dokumente te tillë. Duke e ditur që gjykatat supreme, tregetare , finanaciare konsiderohen si të larta në këtë shtetë , nënkupton se për secilin dokumentë të kërkuar nevojitet kohë për të pritur deri në 28 ditë.

Më poshtë e keni te bashkangjitur linkun i cili i verton fjalet tona :
https://www.tamimi.com/law-update-articles/the-qatar-financial-court-procedural-rules/

Dhe me posht e keni te bashkangjitur foton qe deshmon nje gje te tillë



Pas kësaj ne kemi kerkuar nga ju si AK të na zgjatni aftatin prej 5 diteve duke e ditur që 28 ditë janë shumë dhe janë jasht racionales për projektin e juaj , ndersa ju na keni aprovuare vetem ne 3ditë , ne konsulltime me ekspertet të fushes se prokurimit ju si AK ka qenë dashtë të na aprovoni kërkësen tonë për pritje të afateve kohore .

Ne kemi bere kerkese per interpretim ne KRPP për kete kemi morrur pergjigje me shkrime se AK ka vepruar ne kundershtim me LPP dhe rregulloret ne fuqi, pasi ka qen dashtur qe te na aprovoj kerkesen per zgjatje te afatit per sjelljen e dokumentacionit te kerkuar per antarin ne koncersium i cili eshte nga shteti i huaj.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk e kane respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu nuk e kane respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues duhet të ken në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga OSHP që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të **OE Nika Proing Sh.P.K. & Anion Mep Conctructing**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së dhe lënda kthehet në
RIVLERSIM dhe gjatë rivlersimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, në vlerë prej 100,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

DATË/A	04.06.2024
REFERENC-Ë	KRPP-DRR-04-06-86/2024
PËR/ZA/TO:	OE-Nika Proing Sh.p.k
PËRMES/PREKO /THROUGH:	Z. Osman Vishaj, Kryetar Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
NGA/OD/FROM :	Arbnora Cakolli-Luzha, Drejtore e Departamentit të Rregullave Ismail Rushiti, Ekspert i Prokurimit në Departamentin e Rregullave -KRPP
TEMA/SUBJEKAT /SUBJECT:	Përgjigje në Kërkesën e datës 31.05.2024

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, si në vijim:

Neni 25.9 i Rregullores Nr. 001/2022, përcakton:

"25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se".

Kurdo që AK përcakton afatin kohor prej pesë (5) ditësh në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë për sjelljen e dëshmive sipas nenit 65 të LPP-së, afati i tillë duhet të jetë i mjaftueshëm për OE vendor, por nën rrethanat nga më të ndryshmet mund të jetë jo i mjaftueshëm për OE të

huaj. Prandaj, kurdo që OE i huaj kërkon zgjatje të afatit kohor për sjelljen e dëshmive të specifikuara nga AK duke caktuar në kërkesë edhe numrin e ditëve të nevojshme shtesë me arsyet bindëse me shkrim, kërkesa e tillë duhet të merret si e pranueshme nga AK dhe vetëm pas skadimit të afatit shtesë të kërkuar nga OE dhe dështimit të tij në dorëzimin e dokumenteve të tilla, AK të veprojë në përputhje me dispozitën e lartë cituar.

Gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit, autoriteti kontraktues çdo herë duhet të mbajë në mend qëllimin e LPP-së të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1 të LPP-së, si në vijim:

"1. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë....."

Sipas nenit 59 të LPP-së, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, ***"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..."***

Për të gjithë OE që pretendojnë se AK nuk ka vepruar apo vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, LPP ka paraparë mjetet juridike për ti atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).

Me respekt,

Vërejtje: *Interpretimi i dhënë nga KRPP, i referohet vetëm pyetjes së parashtruar nga ana juaj dhe assesi nuk i dedikohet aktivitetit të prokurimit*